

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit L. V. nga fshati Sh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, nën numrin PP/II.nr.1759-6/2016 të datës 18.08.2016, në shqyrtimin fillestar në prezencën e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij avokat N. Sh. nga Prishtina dhe të dëmtuarit N. B. nga Gjakova, me datë 30.10.2017 në prezencën e palëve publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit

L. V. nga i ati M. dhe e ëma T. e lindur O., i lindur me datë *data e lindjes...* në Prizren, tani me banim në fshatin Sh. Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, bukëpjekës, i martuar, baba i një fëmije, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

Në pajtim me nenin 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK

REFUZOHET AKUZA

Me datë 05.07.2016 rreth orës 14:00, në rrugën e fshatit Sh. – Prizren, në afërsi të marketit, seriozisht e kanos të dëmtuarin N. B. se do të shkaktoj një të keqe, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke drejtuar veturën e markës “Opel Vectra” i akuzuari e ndjek nga mbrapa, kërkon që të ndalet dhe i drejtohet me fjalë “ndalu se kam me ta q...familjen, kamë me të vra”, me ç’rast tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri.

Kësodore kishte për të kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KPK.

Për shkak se prokurori shtetit në Prizren – në shqyrtimin fillestar në mbështetje të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, është tërhequr nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1759-6/2016 të datës 18.08.2016 kundër të akuzuarit L. V. nga fshati Sh. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 të KPK.

Në shqyrtimin fillestar – në seancën e datës 30.10.2017 pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i dëmtuari N. B. deklaroi se vullnetarisht tërhiqet nga propozimi për ndjekje penale, kundër të akuzuarit L. V. dhe atë për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 par.2 të KPK. I dëmtuari theksoj prej ditës kritike me të akuzuarin nuk ka pasur problem dhe asnjëherë

nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim kundërligjor ndaj tij . Andaj propozon gjykatës dhe prokurorit të shtetit që kjo procedurë të përfundoj në mënyrë që çështja të mbyllet pasi që tërheq propozimin për ndjekjen penale të akuzuarit, për veprën penale objekt i akuzës.

Mbrojtësi i akuzuarit avokat N. Sh. pas dëgjimit të deklaratës së dëmtuarit, propozoj prokurorit të shtetit dhe gjykatës të veprojnë në pajtim me ligjin.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar, duke u bazuar në deklaratën e dëmtuarit N. B. dhënë në shqyrtimin fillestar, ku vullnetarisht është tërhequr nga propozimi për ndjekjen penale në dëm të tij, andaj edhe përfaqësuesi i akuzës, është tërhequr nga akuza për veprën penale si në dispozitiv të aktakuzës, pasi që vepra penale e kanosjes nga neni 185 par.2 të KPK, fillon sipas propozimit të dëmtuarit.

Meqenëse prokurori shtetit gjatë shqyrtimit fillestar është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit, gjykata në pajtim të nenit 363 par.1 nën par.1.1 të KPPK, ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1863/2016 të datës 30.10.2017

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes së njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.